

UDHËZIM
Nr. 15, datë 22.6.2022

PËR NJË SHITESË DHE NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 6, DATË 19.2.2018,
“PËR GJENERIMIN DHE DHËNIEN E NUMRAVE TË MATRIKULLIMIT”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 10, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 6, datë 19.2.2018, “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”, të bëhet shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

a) në fund të pikës 2, shtohet:

“Formimi i numrit të matrikullimit, për studentët e regjistruar në programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor”, që japin akses në programet e studimit të ciklit të dytë “Master” në fushën e mësuesisë, të cilët nuk e plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, është sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Numri i matrikullimit, për këtë kategori studentësh identifikohet nga kodi i ciklit të studimit me shkronjën V, e cila nënkupton moslejimin për regjistrim, nga institucionet e arsimit të lartë, në programet e studimit të ciklit të dytë në fushën e mësuesisë dhe mosmatrikullimin nga Qendra e Shërbimeve Arsimore në rast regjistrimi.”;

b) shtojca nr. 1, që është pjesë përbërëse dhe i bashkëlidhet këtij udhëzimi, zëvendësohet me shtojcën nr. 1 me të njëjtin numër.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme për Zhvillimin e Arsimit dhe Sportit, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

SHTOJCA NR. 1
PËR PËRCAKTIMIN E KODIT TË CIKLIT TË STUDIMIT

Cikli i studimit	Shënime	Forma e studimit		Kodi i ciklit
		KP	KZ	
DP/CP	Programe studimi me karakter profesional (1 ose 2 vjet)	KP	KZ	Q
Bachelor	Cikli i parë i studimeve, me kohë të plotë	KP		A
Bachelor	Cikli i parë i studimeve, me kohë të plotë	KP		V
Master i shkencave	Cikli i dytë i studimeve, “Master i shkencave”/“Master i arteve”	KP		B
Master profesional	Cikli i dytë i studimeve, “Master profesional” me kohë të plotë dhe me kohë të zgjatur	KP	KZ	G
PISCD	Programe të integruara të studimeve të ciklit të dytë 5- ose 6-vjeçar, me kohë të plotë	KP		E
Master ekzekutiv	“Master ekzekutiv” cikli i tretë	KP	KZ	K
Specializim afatgjatë	Studime specializuese afatgjata, cikli i tretë			M
Doktoratë	Doktoratë, cikli i tretë			N